



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 08.06.2016

Ref.: 413/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 42-të, të mbajtur më 31 maj 2016, mori:

## V E N D I M

I. APROVOHET kërkesa e BPrAL Kolegji “ESLG” e datës 05.04.2016 për ofrimin e programit të studimit të Fakultetit Evropian të Drejtësisë nga Sllovenia për periudhën katër vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2020:

- Juridik LLB (180 ECTS);

Programi i studimit:

- Juridik dhe Menaxhimi i Infrastrukturës dhe Patundshmërive / LLB (180 ECTS), për periudhën dy vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2018

## Arsyetimi

Kolegji “ESLG” ka parashtruar kërkesë me nr.162/16, datë 05.04.2016 për njohje të akreditimit të programeve të Fakultetit Evropian të Drejtësisë (Evropska Pravna Fakulteta) nga Sllovenia, (Juridik/ LLB /180 ECTS; dhe Juridik dhe Menaxhimi i Infrastrukturës dhe Patundshmërive LLB/180 ECTS ).

Pas vlerësimit të dokumentacionit të ofruar nga parashtruesi i kërkesës, KSHC ne mbledhjen e 42-të datë 31.05.2016 mori vendim pozitiv për njohjen e akreditimit për programet e studimit: (Juridik/ LLB / 180 ECTS; dhe Juridik dhe Menaxhimi i Infrastrukturës dhe Patundshmërive LLB / 180 ECTS ).

Kolegji “ESLG” ka paraqitur në Agjencinë e Kosovës për Akreditim marrëveshjen në mes të këtij institucioni dhe Fakultetit Evropian të Drejtësisë (Evropska Pravna Fakulteta) nga Sllovenia për ofrimin e këtyre programeve në Kolegjin “ESLG”. Gjithashtu Kolegji “ESLG” ka prezantuar edhe vendimin e NAKVIS (Agjencia Nacionale e Republikës së Sllovenisë për Cilësi në Arsimin e Lartë) për akreditimin e këtyre dy programeve të studimit në Slloveni.

Duke u bazuar në nenin 3, pika 1.16 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 28 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim (nr. 02/2013, datë 16.01.2013) institucioni (NAKVIS) i cili e ka dhënë akreditimin e programeve të cekura më sipër, është anëtarë i plotë në Rrjetin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë /ENQA, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kohëzgjatja e njohjes së akreditimit është e njëjtë me kohëzgjatjen e akreditimit të cilin këto programe të studimit e kanë nga Agjencia Nacionale e Republikës së Sllovenisë për Cilësi në Arsimin e Lartë (NAKVIS).

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit ESLG;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë